



Në bazë të nenit 163 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta zyrtare e RM-së” nr. 82/18 dhe “Gazeta zyrtare e RMV-së nr.178/21), neni 207 dhe 321 i Statutit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup dhe neni 21 dhe 49 nga Regullorja për kushtet e posaçme dhe procedurës për përzgjedhje në thirjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe thirjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup numër 02-174/2 e datës 06.04.2021, e lidhur me Vendimin e Drejtorisë Rektoriale të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup numër 02-1432/1 të datës 20.09.2022, Drejtoria Rektoriale e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup shpall:

### KONKURS INTERN

Për angazhimin e demonstratorëve në fakultetet e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, për vitin akademik 2022/2023

- I. Për Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës
  - Nga fusha e arkitekturës ..... (1) demonstratorë
  - Nga fusha e ndërtimtarisë ..... (1) demonstratorë
- II. Për Fakultetin e Shkencave Informatike
  - Nga fusha e informatikës ..... (2) demonstratorë
- III. Për Fakultetin e Shkencave Teknike
  - Nga fusha e shkencave Ekonomike ..... (2) demonstratorë
  - Nga fusha e shkencave Juridike ..... (1) demonstratorë
  - Nga fusha e shkencave të Matematikës ..... (1) demonstratorë
- IV. Për Fakultetin e Shkencave Teknologjike
  - Nga fusha e Tekstilit ..... (1) demonstratorë
  - Nga fusha e Biologjisë ..... (1) demonstratorë
  - Nga fusha e Kimisë ..... (1) demonstratorë
- V. Për Fakultetin e Shkencave Sociale
  - Nga fusha e administratës publike ose shkencave politike ..... (1) demonstratorë
  - Nga fusha punë dhe politike sociale ..... (1) demonstratorë
  - Nga fusha e Gazetarisë ..... (2) demonstratorë
  - Nga fusha e sportit (kineziologjia) ..... (1) demonstratorë
  - Nga fusha e sociologjisë ..... (1) demonstratorë

Për demonstratorë mund të zgjidhet personi i cili i plotëson kushtet e përgjithshme sipas Ligjit për Arsim të Lartë dhe është student në ciklin e dytë ose të tretë të studimeve në programin adekuat studimor.

Kriteriumet për notimin e kandidatëve janë siç vijon:

- a. mesatarja e përfundimit të studimeve deridiplomike (40% nga numri i përgjithshëm i poenave)
- b. mesatarja nga lëndët e domosdoshme të programit studimor në të cilin kandidati ka kryer studimet deridiplomike (50% nga numri i përgjithshëm i poenave)
- c. 10% nga intervista (notë nga kualiteti arsimor profesional të cilin do ta mbulojë)

Përparësi kanë kandidatët të cilët kanë kryer studimet në universitetet të ranguar më lartë. (përlllogaritet faktori i rëndësisë përkatësisht koeficienti sipas rangimit të Universitetit)



Që të zgjidhet kandidati duhet ti plotësojë kriteriumet minimale të parapara në Ligjin për Arsim të Lartë, Rregulloren për kushtet e posaçme dhe procedurës për përzgjedhje në thirjet mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, shkencore, mësimore dhe në thirje bashkëpunëtori në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup si dhe Statutin e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup.

Demonstratori do të angazhohet minimum dy (2), por jo më shumë se në tre (3) lëndë, përkatësisht së paku pesë (6), deri maksimum dhjetë (10) orë në javë.

Për angazhim të plotë maksimal demonstratorit i takon kompenzim në shumë neto prej 10.000 denarëve në muaj.

Demonstratorët do të zgjidhen pas shpaljes së konkursit intern, për vitin akademik 2022/2023.

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Fletëparaqitje
- Biografi të shkurtë CV (me kontakt telefon dhe e-mail adresë)
- Dëshmi se është student i ciklit të dytë ose tretë të studimeve në programin adekuat ose se është i regjistruar.
- Dëshmi se e ka të kryer ciklin e parë të studimeve sipas EKTS me 180 ose 240 EKTS kredi me mesatare në minimum 8,00.
- Vërtetim për provimet e dhëna në ciklin e parë të studimeve;
- Vërtetim për provimet e dhëna në ciklin e dytë të studimeve;
- Vërtetim për provimet e dhëna në ciklin e tretë të studimeve – nëse posedon;
- Vërtetim për njohjen e gjuhës Maqedone dhe Shqipe nëse studimet i ka të kryera në gjuhë tjetër.

Dokumentet duhet të dorëzohen në arkivin e Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, rruga Mirçe Acev nr.4 kati i 7-të, Shkup.

Me dorëzimin e fletëparaqitjes kandidatët për demonstrator janë dakord për tu regjistruar në bazën e kandidatëve për demonstrator në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup.

Dorëzimi i dokumenteve është së fundmi me 28.09.2022.

Me respekt,

Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup